



# Hulumtim

Fëmijët e braktisur në Komunën e Ferizajt

**Lënda:** Metodat Hulumtuese

**Departamenti:** Gjuhë dhe Letërsi Angleze

**Student:**  
Albesë Neziri

**Mentor:**  
Prof. Teuta Agai Demjaha

Maj 2018



Kolegji Universum

DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE SHKENCORE

**Autor:**

Albesë Neziri

**Botues:**

Departamenti i Kërkimeve Shkencore  
Instituti për Studime Ekonomike dhe Sociale  
Kolegji Universum

**Këshilli Editorial:**

Teuta Agai Demjaha  
Arlinda Berisha  
Uran Rraci  
Uresa Vllasa

# Përmbajtja

Motivi

Qëllimet

Definicionet

Metodologjia e punës

Intervistat – Rasti 1, 2 dhe 3

Roli i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare

*Qendra për Punë Sociale*

*Shërbimi Policor*

*Organizatat joqeveritare*

Të dhënat statistikore

Efektet negative

Përfundimet dhe rekomandimet

# Fëmijët e braktisur në Komunën e Ferizajt

## Metodologjia e punës

- Pasi na është dhënë detyra për një hulumtim në kuadër të lëndës “Metodat Hulumtuese”, kemi *përzgjedhur temën*.
- Pastaj kemi *kërkuar leje* nga Kolegji ynë për të pasur *qasje* në institucionin përkatës. *Leja për qasje është aprovuar* nga personi përgjegjës në kolegjin Universum, Kampusi në Ferizaj.
- Hulumtimi është punuar në *bashkëpunim* me Qendrën për Punë Sociale (QPS) në Ferizajgjatë muajit prill 2018. E falemnderojmë QPS për angazhimin dhe përkushtimin.
- Të gjitha të dhënat janë *ofruar nga QPS*. Është bërë një *rishikim i dokumentacionit ligjor* për temën në fjalë dhe materiale tjera relevante për hulumtimin.
- Intervistat 1 dhe 3 janë përshkruar nga *punëtori social* pranë QPS. Intervista 2 është *marrë personalisht*.
- Është respektuar *kodi etiki punës dhe privatësia*. Të gjitha të dhënat janë *anonime*.

## Motivimi

- ▶ Duke u nisur nga ndjeshmëria e problemit të braktisjes së fëmijëve, zgjodha këtë hulumtim pasi konsideroj të raportoj për statusin aktual të fëmijëve të braktisur.
- ▶ A është ky fenomeni në rritje apo në ulje?
- ▶ Cilat janë mundësitë e trajtimit të kësaj dukurie për studim të mëtejshëm të këtyre fëmijëve në komunën e Ferizajt nga paslufta e deri tash?

## Qellimet specifike te hulumtimit

### 1. Shkaqet e braktisjes

*Konkretisht - Vlerësimi i problemit të braktisjes së fëmijëve,*

*shkaqet e braktisjes në komunën e Ferizajt (mundësitë e zvoglimit apo eliminimit në të ardhmen).*

### 2. Roli i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare lidhur me këtë fenomen

### 3. Numri i rasteve nga paslufta deritani në komunën e Ferizajt

### 4. Efektet negative

## Definicionet që janë përdorur në këtë hulumtim:

\* Braktisja – lënia e qëllimshme dhe e imponuar e fëmijës pa mbikqyrje për një periudhë të pacaktuar nga prindi ose kujdestari (heqja e përgjegjësisë).

\* Format e braktisjes – fizike, materiale, emocionale dhe ligjore.

\* Foshnjët – të posalindurit

\* Fëmijët – persona nën moshën 5 vjeq

\* Prindër dhe kujdestarë

\* Familja

## **Fëmijet e braktisur**

(Hyrje e shkurtër)

Definicioni për fëmijët e braktisur shpesh është identifikuar me bonjakët, të abuzuarit ose me fëmijët e rrugës. Në shkencën shoqërore ky term është përdorur për t'iu referuar situatës kur prindi ose kujdestari braktis fëmijën (foshnjen) me qëllim të dukshëm për ndarje dhe situata kur prindi e vendos fëmijën në një institucion pa qëllim për ta braktisur.

Pra, janë ngatërruar rrethanat dhe kushtet materiale të fëmisë me shkaktarët e tjerë të kësaj dukurie që mund të jenë të shumtë.\*

---

\* Përmbledhje të nxjerra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Instituti i Politikës Sociale, Mars 2003, Prishtinë, Raport Hulumtimi.

## Intervistat

### Rasti 1.

*Një burrë i martuar me fëmijë e mashtron dhe e “marton” në vajzë të re pa kurorë. Derisa ai me familjen e vet ligjore jeton në një komunë, vajzën e re e dërgon në një komunë tjetër larg nga familja e tij. Pas një viti bashkëjetesë lind foshnja dhe në atë kohë nëna e foshnjës e kupton se burri e ka mashtruar. Kështu fillojnë problemet dhe vendosin të ndahen. Nëna nuk ka kushte për mirëqenien e foshnjës si dhe nuk ka përkrahje nga familja e saj. Rastin e merr në dorë Qendra për Punë Sociale (QPS) në Ferizaj. Pasi e kontaktojnë burrin, ai e pranon foshnjen si të veten por nuk pranon të kujdeset për të. Duke u gjendur në këtë situatë, zyrtarët e QPS marrin qëndrim që foshnja duhet vendosur në strehimore përkohësisht deri sa të lajmërohet dikush për adoptim ose strehim të përkohshëm.*

### Rasti 2.

*Bashkëshortët kanë një jetë të qetë edhe pse jetojnë në një varfëri goxha të theksuar. Në kohën kur bëhen me tre fëmijë burri vdes. Kjo e çrregullon normalitetin familjar. Pas një viti vdes edhe djali i tyre i vetëm pas pirjes se një helmi (që përdoret në bujqësi) pa dashje.*

*Gruaja nga presioni i madh ibabait të burrit të saj i cili e përjeton keq vdekjen e djalit dhe të nipit, pa dëshirën e saj detyrohet të largohet nga ajo familje duke hequr dorë përfundimisht së qenuri nënë e dy vajzave të saja.*

*Pas konsultimit me zyrtarët e QPS nëna insiston që së paku dy herë në muaj t'i takojë vajzat e saj. Mirëpo vajzat të shtyra nga halla dhe gjyshi i tyre me të cilët jetojnë, nuk pranojnë të takohen me nënën e tyre. Ato janë takuar vetëm dy herë në zyrën për takime në QPS por pa mundësi për të biseduar shtruar për problemin e braktisjes për shkak të komunikimit të tensionuar të vajzave. Ato me gjithë insistimin e nënës për të treguar të vërtetën lidhur me rastin e vdekjes së vëllait të tyre, nuk pranojnë të takohen pasi e konsiderojnë nënën fajtorë për vdekjen e vëllait të tyre. Gjykata nuk ka pasur qëndrim të tillë lidhur me këtë rast.*

### Rasti 3.

*Një vajzë jetime (pa dy prindër) jeton te daja i saj. Në moshën 18 vjeqare mbetet shtatëzënë mirëpo “pa e ditur se kush është babai” i fëmisë. Shtatëzaninë mundohet me çdo kusht ta mbajë fshehur nga te gjithë dhe nga familja e dajës ku jeton. Lind foshnjë vajzë dhe menjëherë vendos*

*ta braktis me gjithë këshillën e punëtorit social për të mos e bërë këtë veprim. Fëmijës menjëherë i gjendet strehim në një familje adoptuese ndërsa për nënën nuk dihet asgjë meqë ajo nuk lë asnjë gjurmë.*

## **Shkaqet e braktisjes**

Nga intervistat e bëra (rasti 1, 2 dhe 3) konstatojmë se rastet më të shpeshta të braktisjes së fëmijëve janë problemet bashkëshortore apo problemet midis partnerëve.

# ROLI I INSTITUCIONEVE QEVERITARE DHE JO QEVERITARE

## Qendra për Punë Sociale

Pasi QPS informohet rreth braktisjes së fëmijës nga burimet e ndryshme (policia, spitali, individët) mirret deklaratë nga nëna. Profesionistet e QPS ofrojnë përkrahje morale për nënën duke e këshilluar dhe i ofrojnë ndihmë sociale.

Në të njëjtën kohë kontaktojnë edhe me babain e fëmijës (nëse e gjejnë) dhe bëhet përpjekje për krijimin e marrdhënieve familjare.

Nëse nëna vendos ta braktis fëmijën, fillon procedura ligjore për zgjidhjen e statusit të fëmijës dhe caktimi i kujdestarit nga organi i QPS për kujdestari.

Fëmija vendoset në familje tjetër për t'iu siguruar kushtet për zhvillim, edukim dhe aftësim për jetë dhe punë të pavarur. Familja që i permbush me sukses detyrimet, mbikqyret nga Organi i Kujdestarisë dhe përkrahet me ndihma sociale.

Familja strehuese lejon vizitat e prindërve. Vendosja në familje përfundon: me marrëveshje, me heqje dorë, me arritjen e moshës madhore të fëmisë, me adoptim dhe me vdekje.

## SHËRBIMI POLICOR I KOSOVËS

Kontakti i policisë bëhet zakonisht nëpërmjet QPS ose spitalit. Kjo bëhet nga njësitë special për shërbime të bashkësise. Ky njësitë organizon edhe ligjerata në shkolla me qëllim të ngritjes së vetëdijes së të rinjeve për këtë problematikë dhe të ngjashme.

Sipas ligjit në Kosovë, braktisja e fëmijeve konsiderohet krim dhe nënat ndiqen penalisht edhe pse ky ligj nuk po gjen zbatim tani për tani nga organet gjegjëse\*.

---

\*Neni 211. **Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës.** 2) Prindi, prindi adoptues, kujdestari apo ndonjë person tjetër i cili ushtron autoritet prindor mbi fëmijen i cili e braktis fëmijen e tillë në një mënyrë e cila rrezikon jetën apo e dëmton rëndë shëndetin e tij, dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

## **ORGANIZATAT JOQEVERITARE**

**SOS fshati dhe Kinder Dorf** - organizatë austriake që bëjnë rehabilitimin e fëmijëve të braktisur apo strehimin e përkohshëm deri sa ai fëmijë të merret nga ndonjë kujdestar apo adoptues. SOS fshati merret me fëmijë të moshës më madhore ndërsa Kinder Dorf merret me foshnje.

Nga sistemimi në SOS fshatin e deri në dalje nga atje me ata fëmijë merret një kujdestar/e që caktohet nga QPS. Ai-ajo kujdeset në mënyrë periodike për shëndetin, ambientimin, gjendjen emocionale dhe probleme të tjera gjatë qëndrimit të fëmijës së braktisur.

## Numri I rasteve të braktisjes së fëmijeve nga paslufta në Komunën e Ferizajit

VITI	FËMIJË TË BRAKTISUR
2001	12
2002	13
2005	6
2008	6
2012	5
2013	5
2014	2
2015	5
2016	3
2017	2

## **EFEKTET NEGATIVE**

Disa nga efektet negative që hasen tek fëmijët:

- Mos vijimi i shkollimit të rregullt
- Sukses i dobët në mësim
- Sjellje asociale
- Largim i shpeshtë nga shtëpia
- Izolim nga moshatarët

Disa nga problemet që shfaqen te nënat:

- paragjykimet shoqërore (mospërkrahja nga familja, “fajtoje kujdestare”)
- statusi ekonomik dhe social
- integrimi dhe rehabilitimi vështirë
- nënat që i braktisin fëmijët me vetiniciativë shpesh shfaqin shenja pendimi

**Po baballarët, a kanë pasoja, a kanë përgjegjësi, a pendohen ata si prind???**

## **Përfundimet dhe rekomandimet**

- Nga tabela e mësipërme shihet një rënie e konsiderueshme e rasteve të braktisjes së fëmijëve në komunën e Ferizajit nga viti 2001-2017.
- Përshkrimi i intervistave jep një indikacion se ekziston një angazhim për përkujdesjen dhe mbarëvajtjen e kësaj kategorie të fëmijëve nga ana e institucioneve përkatëse.
- Një nga arsyet e kësaj rënie është angazhimi i QPS në bashkëpunim me policinë në zvogëlimin apo edhe eliminimin e kësaj dukurie në komunën tonë duke punuar në ngritjen e vetëdijësimit të të rinjëve (organizim i seminareve dhe ligjeratave nëpër shkolla).
- Pasojat nga ky fenomen janë rrjedhojë e mentalitetit tonë konzervativ dhe patriarkal, si dhe e standardeve të dyfishta për gjinitë e ndryshme.
- Duhet bërë studime gjithëpërfshirëse lidhur me këtë problematikë në gjithë territorin e Kosovës.
- Duhet punuar në ngritjen edhe më të madhe të vetëdijes të popullata e re, me fokus të veçantë të grupet vulnerable, gratë dhe fëmijët duke mos anashkaluar edhe ngritjen e vetëdijes të gjinisë mashkullore (baballarët dhe anëtarë të tjerë të familjes).
- Duhet punuar edhe më shumë në eliminimin e barrierave mendore dhe paragjyqimeve të e gjithë popullata duke përfshirë edhe institucionet përgjegjëse lidhur me këtë temë të ndijshme.

#### PRISHTINË

Ulpiana Kampus  
Rr.Nik Prelaj, Objekti i “Beni Dones”  
Tel. +381 38 555 315  
Mob. + 377 44 144 062, 44 168 531  
Skype: universum.college

#### FERIZAJ

Rr.Fan Noli, Nr.156  
Tel. +381 290 324 596  
Mob. + 377 44 354 034  
Skype: universum-ferizaj

#### GJAKOVË

Rr.UÇK-së, përball pallatit të kulturës  
Tel. +381 0390- 330990  
Mob. + 377 44 750 858  
Skype: universum-gjakova

Kolegji Universum është institucion i arsimit të lartë, i akredituar pa kusht nga Agjencia për Akreditim e Kosovës. Programet e studimit, menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë janë vlerësuar shumë lartë nga ekspertët ndërkombëtarë (shih raportet e akreditimit).

*Universum në partneritet me programin Erasmus+ të financuar nga Bashkimi Evropian, ka dërguar për studime jashtë vendit 47 studentë në 44 Universitete Ndërkombëtare të Evropës.*

Universum ka partneritetet më të fuqishme ndërkombëtare nga të gjitha institucionet që veprojnë në Kosovë. Është i binjakëzuar me Chichester College (Angli), anëtarësuar në Global College Network, Anglia Network Europe, European Higher Education Society dhe ka mëse 30 institucione partnere nga e gjithë bota.

*Universum është renditur në Top 1000 Shkollat më të mira të biznesit në Botë nga Eduniversal, si i vetmi institucion nga Kosova.*